

**VENDIM**  
**Nr. 309, datë 11.5.2022**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR  
PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Nga fondet e miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në programin buxhetor “Arsimi bazë” 09120, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, shuma prej 168 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë) lekësh, të rishpërndahet për mbulimin e shpenzimeve, për tatimin mbi vlerën e shtuar, për pajisjet e furnizuara për objektet arsimore, të ndërtuara në kuadër të programit të rindërtimit “*EU4schools*”, në vitin 2021, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit, me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për programin “*EU4schools*”, me përfitues njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë të realizojnë rishpërndarjen e fondeve për llogari të njërive të vetëqeverisjes vendore, pas paraqitjes prej tyre të kërkesës për rimbursimin e tatimit mbi vlerën e shtuar, si dhe dokumentacionit shoqërues të mallrave të blera në kuadër të programit “*EU4schools*”, në vitin 2021, kopjeve të kontratës/ave të nënshkuara, kopjeve të faturave tatimore, të lëshuara nga kontraktori/ët, aktet e marrjes në dorëzim të mallit/mallrave dhe fletëhyrjes së pajisjeve të furnizuara.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**